

VENDIM
Nr.2, datë 23.1.2006

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RREGULLAT DHE KUFIJTË E INVESTIMIT
TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT”**

Në mbështetje të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, nenit 58 dhe pikës 2 të nenit 95 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Rregullorja hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
 3. Rregullorja t’u dërgohet për zbatim shoqërive të sigurimit.
- Ky vendim hyn në fuqi më 23.1.2006.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera